



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA**

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

**AGJENCIONI EKZEKUTIV I INSPEKTORATIT TË PUNËS  
EXCECUTIVE AGENCY OF LABOUR INSPECTION  
EGZEKUTIVNA AGENCIJA INSPEKTORATA RADA.**

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 03/05  
PËR**

**ZBATIM TË DISPOZITAVE TË LIGJIT NR. 2002/9 PËR INSPEKTORATIN E  
PUNËS NË KOSOVË**

Bazuar në dispozita të nenit 3 parag.3.2 dhe të Shtojcës VII,të Rregullorës Nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkoħshme të Vetqeverisjes në Kosovë,

Në bazë të dispozitave të nenit 4 parag.4.3.pika a,b,c dhe d dhe të dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.2002/9,për Inspektoratin e Punës në Kosovë,

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë,Ministri i Punës dhe Mirëqenjes Sociale,nxjerr

**UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR.03/05  
PËR**

**ZBATIM TË DISPOZITAVE TË LIGJIT NR.2002/9 PËR INSPEKTORATIN E  
PUNËS NË KOSOVË**

**Neni 1.**

**Qëllimi**

**1.1.Qëllimi nxjerrjes së këtij Udhëzimit Administrativ,është zbatimi i dispozitave të Ligjit Nr.2002/9,për Inspektoratin e Punës në Kosovë,ku do të krijohen kushtet optimale për zbatim të drejtë të dispozitave të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë,Ligjt për Siguri në Punë,Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës si dhe të dispozitave tjera ku rregullohet lëmi i punës,punësimit,sigurisë në punë,mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.**

**Neni 2.**

**Fushëveprimi.**

**2.1.Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës ushtron mbikqyrje në aplikimin e dispozitave të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë,Ligjt për Siguri në Punë,Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës si dhe të dispozitave tjera ku rregullohet lëmi i punës,punësimit,sigurisë në punë,mbrojtjes së Shëndetit të Punësuarve dhe ambientit të punës.**

**2.2.Mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave pozitive ku rregullohet lëmi i sigurisë në punë,mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës,në Shërbimin Civil të Kosovës,ushtron Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës.**

**2.3.Në pajtim me dispozitat e nenit 1(përkufizimet) parag.1 pika c alineja 2,të Rregullores Nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës,ndërmarrjet publike,shtetërore dhe ndërmarrjet në pronësi shoqërore nuk përfshihen në Shërbimin Civil të Kosovës..**

**2.4.Mbikqyrjen e aplikimit të dispozitave ligjore dhe të dispozitave tjera ku rregullohet lëmi i punës,punësimit,sigurisë në punë,mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe të ambientit të punës,në miniera siperfaqësore,ushtron Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës,kurse në miniera nëntoksore,mbikqyrje ushtron Organi kompetent i xehtarise.**

**Neni 3.**

**Kryeinspektori i Punës dhe zëvendësit e tij.**

**3.1.Kryeinspektori i Punës dhe zëvendësit e tij:**

**(I) udhëheqin Agjencionin Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës dhe janë përgjegjës për zbatimin e detyrave të këtij Organi;**

- (ii) ushtrojnë mbikqyrje profesionale në punës, me qëllim të aplikimit sa më të drejtë të dispozitave pozitive, ku rregullohet lëmi i punës, punësimi, sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës në Kosovë;
- (iii) inspektorëve të punës, në vazhdimësi iu jepin ndihmë profesionale, për ushtrimin e funksionit të tyre;
- (iv) inspektorëve të punës, u jepin instrukcione dhe udhëzime të obligueshme, me qëllim të ushtrimit të mbikqyrjes inspektuese në mënyrë profesionale dhe me azhuritet të plotë;
- (v) punëdhënësve dhe punëmarrësve, iu jepi këshilla profesionale për aplikim sa më të drejtë të dispozitave, ku rregullohet lëmi i punës, punësimi, sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës;
- (vi) organizojnë dhe përcjellin trajnimet për inspektor të punës;
- (vii) organizojnë dhe udhëheqin bashkëpunimin me organet tjera, në veçanti me ato që ushtrojnë mbikqyrje të aplikimit të dispozitave pozitive;
- (viii) paraqesin iniciativa për ndryshime dhe plotësimë të dispozitave ku ushtron mbikqyrje ky Organ;
- (ix) në bashkëpunim me inspektorët e punës, mund të kryejnë punë të caktuara inspektuese, në interes të ushtrimit të mbikqyrjes sa më të plotë, efikase e profesionale dhe në rastet kur vlerësojnë se inspektori i punës nuk është duke e ushtruar funksionin e vetë në mënyrë profesionale e efikase dhe
- (x) në bashkëpunim me inspektorin e punës, bëjnë vendshiqimin për rastet e vdekjeve në punë dhe lëndimeve kolektive.

**3.2. zëvendësit e Kryeinspektorit të Punës për siguri në punë, ushtrojnë mbikqyrje të drejtëpërdrejtë inspektuese (në lëmin e sigurisë në punë), në ndërmarrje të metalurgjisë së zezë dhe të ngjyrosur, në ndërmarrje të prodhimit, bartjes dhe distribuimit të energjisë elektrike e në objekte mbi 10 KV, në komunikacionin hekurudhor dhe në ndërmarrje tjera me rrezikshmëri dhe teknologji të përsosur.**

#### Neni 4.

##### Autorizimet dhe procedura për inspektor të punës.

- 4.1. Mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Ligjit për Siguri në Punë, Mbrotje të Shëndetit të Punësuarve dhe të Ambientit të Punës dhe dispozitave tjera ku rregullohet lëmi i punës, punësimi, sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës e bënë inspektori i punës, përvëq punëve që me dispozita të këtij Udhëzimi Administrativ dhe me dispozita tjera të veçanta, janë lënë në kompetencë të drejtpërdrejtë të Kryeinspektorit të Punës dhe zëvendësve të tij.**
- 4.2. Inspektori i punës aktivitetin e vetë e ushtron, në pajtim me Planin e punës të Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës.**
- 4.3. Pos kontrollimeve të rregullta inspektuese, inspektorët e punës, janë të obliguar për të kryer edhe kontrollime të jashtëzakonshme inspektuese, te punëdhënësit ku më parë janë urdhëruar masa për evitimin e parregullësive të konstatuara.**
- 4.4. Përkitazi me gjendjen e konstatuar dhe masat që duhet ndërmarrë, inspektori i punës është i obliguar për ta hartuar procesverbalin, respektivisht shënimin zyrtar adekuat, së paku dy kopje të të cilat i lihen punëdhënësit.**
- 4.5. Nëse inspektori i punës, me rastin e kontrollimit inspektues, konstaton parregullësi, të cilat punëdhënësi nuk i ka evituar, me aktvendim do ta urdhëroi, që mbrenda afatit të caktuar ti evitoi të metat e konstatuara.**

**4.6.** Inspektori i punës, ka të drejtë për të urdhëruar edhe aplikimin e masave të pa parapara, kur konstaton se është rrezikuar jeta apo shëndeti i të punësuarve.

**4.7.** Inspektori i punës, me rastin e kontrollimit inspektues, nëse konstaton parregullësi në lëmin e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, menjëherë duhet ta urdhëroi punëdhënësin për ti aplikuar masat adekuate të sigurisë në punë, respektivisht ta ndalë procesin e punës deri sa të evitojen ato parregullësi apo të mos aplikohen ato masa.

**4.8.** Me rastin e kontrollimit inspektues, inspektori i punës, në bashkëpunim me Kryeinspektorin e Punës, mund të angazhojë ekspert të lëmive, për të cilat ky Organ nuk ka ekspert adekuat.

**4.9.** Në bazë të lajmërimit të punëdhënësit, për fillimin e punës në punishtë apo për kryerje të punëve jashtë selisë së ndërmarrjes, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së sigurisë në punë, inspektori i punës bënë vlerësimin se a janë përbushur kushtet për fillimin e punëve apo cilat masa të sigurisë në punë duhet ndërmarrë për fillimin e punës.

#### Neni 5.

##### **Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave.**

**5.1.** Për mbrojtjen e të drejtave nga lëmi i punës, punësimi, sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës i punësuari, mund ti drejtohet inspektorit të punës.

**5.2.** Nëse inspektori i punës, konstaton se janë cenuar të drejtat e të punësuarit, menjëherë ja bënë me dije punëdhënësit shkeljen e bërë.

**5.3.** Në rastet kur i punësuari e ka filluar kontestin e punës në gjykatën kompetente, kurse inspektori i punës e konstaton se çartë janë cenuar të drejtat e të punësuarit, me aktvendim do ta ndalë ekzekutimin e vendimit të punëdhënësit, deri sa gjykata të merr vendim definitive përkitazi me këtë qështje juridike.

**5.4.** Nëse i punësuari vlerëson se drejtëpërsëdrejti i kanoset rreziku për jetë, respektivisht shëndet, ka të drejtë për të refuzuar për të punuar në ato punë, mirëpo është i obliguar menjëherë për ta lajmëruar punëdhënësin dhe inspektorin e punës, në mënyrë që të aplikohen masat e sigurisë në punë, përkatësisht të informohet se për cilat shkaqë kërkesa e tij është e pabazuar.

#### Neni 6.

##### **Masat ndëshkuese**

**6.1.** Nëse inspektori i punës, konstaton cënimin e normave të sankzionuara:

(i) shqipton gjobën deri në 500 € (denim mandatar);

(ii) në vlerë më të lartë se 500€, do ti bëjë kërkesë gjykatës kompetente për fillimin e procedures për kundërvajtje;

(iii) në rastet kur cenimi i dispozitës parashihet delikt ekonomik, do ta inicdoi procedurën adekuate në gjykatën kompetente ekonomike dhe

(iv) në raste kur cenimi i dispozitës parashihet vepër penale, do ta inicdoi procedurën penale.

**6.2.** Nga shuma e gjobës së shqiptuar, 70% e kësaj shume paguhën në Bugjetin e Kosovës, 20% e kësaj shume paguhën në Fondin për Nxitje të Punësimit dhe 10% e kësaj shume paguhet në Fondin e Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës të Kosovës.

**6.3.** Nëse inspektori i punës, gjat kontrollimit inspektues, konstaton cënimin e dispozitave që janë në kompetencë të organeve tjera të mbikqyrjes, obligohet për ta informuar organin kompetent.

Neni 7.

**Ndryshimet dhe plotësimet**

7.1.Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Udhëzimi Administrativ,mund ti inicojnë Ministri i Punës dhe Mirëqenjes Sociale, Kryeinspektori i Punës dhe zëvendësit e tij.

Neni 8.

**Zbatimi**

8.1.Për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ përkujdeset Kryeinspektori i Punës,i cili me autorizimin e Ministrit të Punës dhe Mirëqenjes Sociale,mund të nxjerr vendime apo akte tjera nënligjore.

Neni 9.

**Hyrja në fuqi.**

9.1.Udhëzimi Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe i Mirëqenjes Sociale.

*Prishtinë,qershori 2005.*

**MINISTRI  
I PUNËS DHE MIRËQENJES SOCIALE**

*Ibrahim Selmanaj*

